

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE ELEKTRIKE**

**METODOLOGJIA E LLOGARITJES SË TARIFAVE PËR KOMPANINË  
PUBLIKE TË PRODHIMIT**

**Pjesa e I**

**Qellimi**

Qellimi i kesaj metodologjie eshte te caktoje tarifat e kompanise publike te prodhimit te bazuara ne parimet e njohura te vendosjes se tarifave te drejta dhe transparente mbi bazen e te dhenave te detajuara, te cilat transmetojne sinjalet e duhura te cmimeve.

**Objektivi**

Objektivi i kesaj metodologjie te llogaritjes te tarifave te prodhimit publik eshte te percaktoje tarifa te vecanta per centralet/njesite prodhuese te Kompanise Publike te Prodhimit (KPP), duke paraprire hyrjen e tyre eventuale ne tregun rajonal te konkurrences. Metodologjia e tarifave do te paraqese konceptet tarifimit te sherbimeve ndihmese te ndare me cmime perkatese per cdo central/njese prodhuese, ne menyre te tille qe te kemi qendrueshmeri dhe siguri te sistemit.

**1. Termat e përdorur në metodologji**

Termat standarte të përdorur në kete rregullore përcaktohen në Ligjin nr.9072, datë 22.05.2003 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", te ndryshuar, Rregullat e Tregut, Kodin e Matjes, Kodin e Transmetimit dhe aktet e tjera nënligjore të miratuara nga ERE. Termat e përdorur në këtë metodologji kanë kuptimin si më poshtë.

- 1.1 **Sherbimet Ndihmese** – Sherbime te siguruar nga KPP ndaj OST-se per sigurine dhe qendrueshmerine e sistemit sipas cmimeve te percaktuara nga ERE.
- 1.2 **Viti bazë** – periudha 12 mujore gjatë së cilës tarifat e KPP-së të miratuara nga ERE aplikohen për faturat e kompanise se furnizuesit publik me shumice. Fillimi i vitit bazë është data në të cilën kosto e energjisë elektrike të KPP-së i ngarkohet kompanise se furnizuesit publik me shumice sipas tarifave të reja të KPP-së.
- 1.3 **Kapaciteti gjenerues i qendrueshem** – kapaciteti i instaluar gjenerues disponibel per te plotesuar ngarkesën pik të parashikuar të sistemit elektroenergjitik shqiptar. Per hidrocentralet kapaciteti gjenerues i qendrueshem eshte kapaciteti mesatar i disponueshem gjate muajve pik te vitit bazuar mbi disponibilitetin e paisjeve dhe rezervave ujore te nje viti normal. Per termocentralet kapaciteti gjenerues i qendrueshem eshte prodhimi neto i termocentralit i axhustuar/rishikuar me nderprerjet standarte te planifikuara dhe/apo te detyruara.
- 1.4 **Njese ekonomike prodhuese** – Nje hidro kaskade, grupe te mesem apo te vegjel hidrocentralesh apo termocentralesh te te njejtës madhesi.

- 1.5 Tarifa e KPP-se per energjine dhe kapacitetin** – një tarifë e diferencuar e llogaritur per secilen njesi ekonomike prodhuese ne perputhje me kostot e parashikuara në vitin bazë; tarifa për shitje të energjisë nga KPP-ja qe perfshin tarifen qe lidhet me kapacitetin, tarifen qe lidhet me energjine, sipas termave te marreveshjes/ protokollit te brendshem me furnizuesin publik me shumice.
- 1.6 Tarifa KPP-se per sherbimet ndihmese** – Tarife e cila duhet llogaritur sipas metodologjise perkatese per sherbimet ndihmese e miratuar nga ERE.
- 1.7 Prioriteti i sherbimeve** - Centralet prodhuese duhet te ofrojne sherbime sipas kesaj rradhe – sherbime ndihmese ndaj OST, shitje ndaj OST per te mbuluar humbjet teknike ne rrjetin e transmetimit , shitje energjie dhe kapaciteti ndaj furnizuesit publik me shumice, dhe shitje ne tregun konkurues te energjise elektrike.
- 1.8 Baza e Rregulluar e Aseteve (RAB)** – vlera e asetave fikse që zotërohen nga KPP-ja dhe përdoren për të siguruar energji dhe kapacitet për kompanine e furnizuesit publik me shumice dhe sherbime ndihmese ndaj OST-se, ne menyre qe ajo te permbushe detyrimet per te ofruar siguri dhe qendrueshmeri te sistemit elektroenergjetik. ERE duhet te miratoje se sa do te jete RAB.
- 1.9 Periudha rregullatore** – periudha gjate se ciles tarifat e reja behen efektive dhe rregullohen/rishikohen sipas vendimit te marre nga ERE.

## **2. Rregullat e përgjithshme dhe parimet bazë**

- 2.1** Mospajtimi me ndonje pjese te kesaj rregullore mund te rezultoje ne refuzim te aplikimit te tarifes se KPP nga ERE.
- 2.2** Kjo metodologji eshte zhvilluar konform ligjit te sektorit elektroenergjistik, Modelit Shqiptar te Tregut, si edhe akteve te tjera ligjore qe jane ne fuqi ne Republiken e Shqiperise dhe legjislacionit sekondar te aprovuar nga ERE.
- 2.3** ERE do te percaktoje tarifat bazuar ne keto parime :
- Tarifat duhet te pasqyrojne koston e sherbimit.
  - Tarifat duhet te sigurojne nxitje per nivelin e pershtatshem te investimeve ne burime prodhuese dhe kapaciteteve qe lidhen me to, per te siguruar furnizim te sigurte dhe te qendrueshem gjate jetegjatesise se tyre.
  - Te gjitha tarifat e prodhimit duhet te behen ne menyre graduale te krahasueshme me cmimet e tregut deri ne momentin e krijimit te Tregut Rajonal te Eenergjiise Elektrike.

- Tarifat duhet të sigurojnë sinjale të qarta çmimesh që nxitin përdorimin me efikasitet të energjisë elektrike nga konsumatorët.
  - Shpenzimet të përfshira në tarifën e rregulluar duhet të jenë transparente për të gjitha palët e interesuara për të marrë një normë të arsyeshme të kthimit mbi bazën e rregulluar të aseteve.
  - Vetëm shërbimet dhe produktet e blera në mënyrë të kujdesshme nga KPP të energjisë elektrike do të pranohen në tarifën e prodhimit.
  - Çmimet për shërbimet e energjisë elektrike duhet të jenë relativisht të qëndrueshme përgjatë kohës.
- 2.4 Pagesat për energji dhe kapacitet ndaj KPP do të behen nga furnizuesi publik me shumicë në përputhje me marrëveshjet apo protokollin e brendshëm, të bazuara në tarifën e KPP-së. Pagesat për shërbimet ndihmëse do të behen nga OST-ja në përputhje me Kontratat e Shërbimeve Ndihmëse.
- 2.5 Tarifa e KPP nuk duhet të përdoret për të mbuluar kostot e ndonjë aktiviteti që nuk është i lidhur me shitjen e energjisë dhe kapaciteteve, për humbjet në transmetim, shitjen e energjisë dhe kapaciteteve furnizuesit publik me shumicë ose shitjen e shërbimeve ndihmëse OST-së. KPP ka detyrimin që të sigurojë energji elektrike dhe kapacitet për furnizuesin publik me shumicë dhe shërbime ndihmëse për OST sipas çmimeve të rregulluara bazuar në kostot e prodhimit dhe jo në çmimet e tregut të energjisë elektrike.
- 2.6 Shërbimet ndihmëse do të paraqiten me çmime të rregulluara. Në momentin që ERE identifikon se përmbushen kushtet e mjaftueshme të tregut për shërbimet ndihmëse, atëherë do të krijohet një treg konkurrencës për të vendosur çmimin e atij shërbimi ndihmës.
- 2.7 ERE do të miratojë formate standarte të tabelave për qëllime të aplikimit për tarifë. KPP duhet të përdorë formatet e tabelave të miratuara nga ERE për të aplikuar për tarifë për periudhën e rregullimit. Formatet e tabelave mund të modifikohen nëse informacioni është i organizuar në mënyrë të ngjashme dhe detajimi i informacionit nuk është më i vogël se ai i kërkuar në tabelat standarte të miratuara.
- 2.8 Formatet e tabelave do të tregojnë rezultatet e vitit të testimit, rregullimet e bërë ndaj vitit të testimit dhe rezultatet e vitit bazë, duke përfshirë por jo duke u kufizuar në shpenzimet e kompanisë, shpenzimet e kapitalit dhe bazën e rregulluar të aseteve për kryerjen e aktiviteteve të rregulluara. Shpenzimet që lidhen me kapacitetin dhe energjinë sipas Usos (Sistemi i Njëte i Llogarive) do të listohen të ndara në tabelë sipas listës së llogarive (numrave perkates) të miratuar nga ERE.
- 2.9 Tarifa e KPP do të bazohet në kostot që do të shkaktohen nga një kompani prodhuese e menaxhuar mirë, e cila realizon investime të kujdesshme dhe shmang shpenzimet e tepërta. Gjate procesit të përcaktimit të tarifës së kompanisë së prodhimit, ERE ka të drejtë të investigojë nivelet e kostos të raportuara nga

kompania e prodhimit dhe te krahasoje koston per njesi te saj me ate te kompanive te tjera prodhuese ne Shqiperi dhe ne Rajon.

### 3. Viti Testues, Viti Baze dhe Periudhat Rregullatore

- 3.1 ERE vendos per periudhat e pershtatshme te rregullimit per KPP. Procesi i rishikimit te tarifave ekzistuese behet per rishikime vjetore te te ardhurave te kerkuara per cdo central/njesi prodhimi te KPP duke percaktuar cmimet perkatese per kapacitet dhe per energji, si dhe tarifat per sherbimet ndihmese.
- 3.2 ERE mund te miratoje ne te ardhmen perdorimin e metodologjise se tarifimit “**price cap**” ose “**revenue cap**” per KPP-ne..
- 3.3 Periudha e pare e rregullimit sipas kesaj metodologjie do te jete viti kalendarik 2009.
- 3.4 Nese ERE miraton nje metodologji tarifimi “price cap” apo “revenue cap”, periudhat e rregullimit per prodhuesit e energjise elektrike do te jene ne perputhje me ato te OST, OSSH dhe Furnizuesit Publik me Shumice.

### 4. Prodhimi neto dhe kapaciteti prodhues i instaluar

- 4.1 Sasia totale e energjise elektrike qe duhet levruar nga KPP ne rrjetin e transmetimit do te jete ne perputhje me grafikun orar te dispecerimit, i miratuar nga palet. Cdo mungese ose teprice ne sasine e energjise se prodhuar nga KPP gjate nje ore do te jete pergjegjesi e kesaj te fundit, e cila do t'i nenshtrohet rregullimeve balancuese te administruara nga OST-ja.
- 4.2 KPP-ja duhet te vendose kapacitetin prodhues te instaluar te disponueshem per cdo central prodhimi ne perputhje me rregullat e tregut. KPP-ja duhet te vleresoje gjithashtu nivelin e kapacitetit prodhues te qendrueshem per cdo central prodhimi. Ky informacion duhet verifikuar nga OST-ja dhe me pas t'i jepet ERE-s dhe kompanise se Furnizuesit Publik me Shumice.
- 4.3 Cdo kapacitet qe nevojitet per te permbushur kerkesen per sherbimet ndihmese duke perfshire dhe nevojat e balancimit per OST-ne, do te rezervohet nga KPP-ja dhe nuk do te ofrohet per shitje tek Furnizuesi Publik me Shumice. Pjesa e mbetur e kapaciteteve dhe energjise do t'i ofrohet Furnizuesit Publik me Shumice deri sa te plotesohet kerkesa per energji e konsumatoreve tarifore. Ne momentin qe te gjithe konsumatoret kthehen ne konsumatore te kualifikuar, KPP do te jete e lire te shese ne tregun e hapur. Ne qofte se disa konsumatore do te preferojne te qendrojne si konsumatore tarifore dhe KPP nuk eshte ne gjendje te shese ne tregun konkurues,

atehere Furnizuesi Publik me Shumice eshte i lire te negocioje me prodhuesit bazuar ne tarifa jo me te larta se ato te miratuara nga ERE per cdo njesi prodhuese.

- 4.4 Ne qofte se Furnizuesi Publik me Shumice percakton se jo i gjithe prodhimi nga KPP-ja nevojitet per te permbushur kerkesen e konsumatoreve tarifore, KPP-ja mund ta shese kapacitetin ose energjine e tepert ne tregun konkurues te energjise elektrike.

## **5. Te ardhurat e kerkuara dhe llogaritja e tarifave per sherbimet ndihmese**

- 5.1 KPP-ja do te siguroje sherbime ndihmese te kerkuara nga OST ne perputhje me Rregullat e Tregut.
- 5.2 Cmimet e rregulluara te sherbimeve ndihmese do te percaktohen nga ERE per vitet e para te rregullimit te tarifave. KPP-ja ne bashkepunim me OST-ne do te ndermarre nje studim te aspektit teknik, ekonomik dhe tregut te energjise per kostot e prodhimit dhe transmetimit qe lidhen me parashikimet e sherbimeve ndihmese.
- 5.3 Aspekti teknik i ketij studimi do te identifikojte njesite prodhuese dhe aktivitetet e lidhura me parashikimet e sherbimeve. Njesite prodhuese te cilat ofrojne sherbimet ndihmese duhet te identifikohen nga OST-ja ( si p.sh.njesite qe sigurojne kontrollin e frekuences ose ato qe sigurojne sherbimin e “black start”).
- 5.4 Faktoret e alokimit/shperndarjes per cdo njesi lidhur me sherbimin dhe kostot per realizimin e tij, percaktohen nga ekspertet teknike. Aspekti ekonomik eshte konvertimi ne vlere monetare i rezultateve teknike ne te ardhurat e kerkuara. Aspekti perfundimtar i studimit eshte percaktimi i kostos se pershtatshme per realizimin e sherbimit dhe nivelin e parashikuar te sherbimit qe nevojitet ne treg ne periudhen e parashikuar. Rezultatet perfundimtare jane tarifa te vecanta te rregulluara per cdo sherbim ndihmes.
- 5.5 Ne mungese te nje studimi te detajuar per periudhen e pare te rregullimit, ERE mund te miratoje vlere nominale te tarifave te sherbimeve ndihmese. KPP-ja gjithesesi do e marre nivelin e te ardhurave te kerkuara nepermjet shitjes se kapaciteteve dhe energjise tek Furnizuesi Publik me Shumice, nderkohe qe percakton procedurat per parashikimin dhe shitjen e sherbimeve ndihmese.

## **6. Kerkesat per te ardhura per sherbimet e energjise dhe kapacitetit**

- 6.1 Tarifat e rregulluara te KPP duhet te mbulojne koston e pronesise, koston e nderimit, te operimit dhe te mirembajtjes se centraleve prodhuese, koston e digave te perdorura per prodhim hidroenergjitik dhe truallit, ndertesave, rrugeve, dhe pajisjeve/instrumentave te komunikimit qe lidhen me to.

- 6.2 Kompania e rregulluar duhet te raportoje ne menyre te qarte dhe pa gabime, sipas tabelave standarte te miratuara nga ERE, kostot e cdo sherbimi te rregulluar, duke perfshire vetem asetet dhe aktivitetet qe lidhen me sherbimet e rregulluara. Metoda e shperndarjes se kostove duhet te jete e qarte dhe do te miratohet nga ERE.
- 6.3 Te ardhurat e parashikuara nga shitja e energjise per mbulimin e humbjeve teknike ne transmetim dhe e sherbimeve ndihmese tek OST ne vitin baze nuk duhen perfshire ne te ardhurat e kerkuara (RR) per shitje te energjise dhe kapacitetit tek Furnizuesi Publik me Shumice ne vitin baze.
- 6.4 Kostot qe lidhen me marketingun dhe shitjen e tepricave te energjise dhe kapaciteteve prodhuese nuk duhen perfshire ne te ardhurat e kerkuara per shitje te energjise dhe kapacitetit tek Furnizuesi Publik me Shumice ne vitin baze.
- 6.5 Vetem kostot ekonomikisht te justifikuara te cilat i perkasin aktivitetit te rregulluar per shitjen e energjise dhe kapacitetit tek Furnizuesi Publik me Shumice duhen perfshire ne llogaritjen e tarifave.
- 6.6 Për përgatitjen e aplikimit për tarifa, KPP-ja do të përpiqet të paraqesë me saktësi të gjithë kostot deri në 100.000 leke. Rregullatori nuk do të investigoje shuma më të vogla se 100.000 leke përveç kur ka një mosmarrëveshje lidhur me kompensimin ose pagesën për persona fizikë të veçantë.

## 7. Norma e kthimit mbi Bazen e Rregulluar te Aseteve

- 7.1 Baza e Rregulluar e Aseteve per nje sherbim te licensuar perfshin asetet e trupezuara dhe te patrupezuara, minus amortizimin e akumuluar te aseteve , plus komponentin e kapitalit punues. RAB llogaritet sipas kesaj formule:

$$RAB = A - CG - D + WC + INV$$

ku :

RAB Baza e Rregulluar e Aseteve;

A Vlera e njohur e aseteve ne perdorim ne fillim te periudhes rregullatore;

CG Vlera e aseteve te krijuara nepermjet dhurimeve;

D Vlera e akumuluar e amortizimit te aseteve te perdorura ne periudhat e meparshme per te kryer aktivitetin e licensuar Amortizimi per investimet e reja pergjate periudhes rregullatore do te jete e barabarte me mestaren vjetore kumulative te amortizimit te mesvitit.

- WC Kerkesat per kapitalin e punes
- INV Vlera mesatare nominale kumulative e investimeve e parashikuar per mesviten, te miratuar nga ERE, qe do te investohen gjate periudhes se rregullimit
- 7.2 Jo te gjitha asetet e KPP mund te perfshihen ne RAB, per qellim te llogaritjes se tarifes per sherbimin e licensuar. Asetet te cilat nuk e mbeshtetin sherbimin e licensuar do te perjashtohen nga baza e asetëve te rregulluara. Shembuj te asetëve te perjashtuar nga RAB perfshijne, por nuk kufizhen vetem ne, asetë te perdorura per aktivite te palicensuara, asetë te perdorura per argetim, apo asetë te blera nga kompania prodhuese mbi vleren e tregut. ERE me mbeshtetjen e vleresimeve te konsulentëve apo stafit te saj, duhet te percaktoje vleren e tregut te asetëve vetem ne ato raste kur vlera e investimit eshte e diskutueshme.
- 7.3 Toka dhe te drejtat e servitutit (qe kane lidhje me token) te perdorura nga KPP mund te vleresohen me koston origjinale te blerjes te rregulluar me nivelin e inflacionit. Nuk eshte e nevojshme te percaktohet vlera e tregut te tokes.
- 7.4 Financimet afatgjata te KPP-se duhen perdorur per te financuar shpenzimet kapitale per riparimin dhe rinovimin e centraleve ekzistues, por nuk duhen perdorur per te mbuluar shpenzimet operative.
- 7.5 Amortizimi i asetëve do te bazohet ne studimin me te fundit ne lidhje me amortizimin e asetëve, te kryer nga KPP dhe te aprovuar nga ERE dhe qe do te tregojte jeten e asetëve sipas kategorive te bazuara ne nje studim inxhinierik. ERE do te zbatoje sistemin fiskal per llogaritjen e amortizimit per qellime te rregullimit, por mund te vendose te perdore norma te tjera amortizimi ne raste te vecanta.
- 7.6 Niveli i lejuar i kapitalit te punes ne RAB do te bazohet ne nje studim te praqitur nga KPP per fondet qe nevojiten per te mbajtur nje nivel te pershtatshem te materialeve dhe te furniturave, dhe sasine e parave qe duhen per te permbushur detyrimet korente. Cdo studim i tille duhet perfshire ne aplikimin e KPP-se te praqitur ne ERE-s. Ne mungese te ketij studimi, KPP-ja mund te jape nje vleresim te nivelit te lejuar te kapitalit te punes me evidenca te shkruara qe justifikojne kete vleresim.
- 7.7 Norma e fitimit per KPP-ne nuk duhet te reflektuje ndonje aset te perftuar nepermjet dhurimit.
- 7.8 KPP-ja do te siguroje rezultatet e cdo rivleresimi te asetëve te trupezuara, i cili eshte kryer pas aplikimit te fundit te tarifave ne perputhje me ligjin shqiptar per kontabilitetin dhe Standartet Nderkombetare te Kontabilitetit. KPP-ja do te siguroje nje ndarje te asetëve sipas kategorive, te perfshira ne bazen e rregulluar te asetëve, para dhe pas rivleresimit. (Aspekte te vleresimit te asetëve do te jepen ne Praktikat dhe Procedurat e kontabilitetit te korporates).

- 7.9 Norma e lejuar e kthimit mbi RAB-in llogaritet nga nje vlere e lejuar e kthimit mbi kapitalin ne vitin baze, me nje vleresim te normes mesatare te interesit per kredite afatgjata gjate vitit baze, dhe raportin borxh/kapital i vet. Te tre keto vlera duhen dhene ne vendimin per tarifen te miratuar nga rregullatori, ne menyre te tille qe supozimi i perdorur per te llogaritur normen e lejuar te kthimit mbi RAB-in te jete i paraqitur qarte. Norma e lejuar e kthimit para takse mbi RAB-in eshte :

$$\text{WACC} = [\text{ES} * \text{ARoE} / (1-\text{T})] + (\text{DS} * \text{CoD})$$

$$\text{ES} + \text{DS} = 1$$

**Ku :**

**WACC = Kosto mesatare e ponderuar e kapitalit**

**ES = Objektiv i per raportin e kapitalit te vet ne RAB`**

**T = Norma e Takses**

**ARoE = Norma e lejuar e kthimit mbi kapitalin e vet pas takse**

**DS = Objektiv i per raportin e borxhit te RAB**

**CoD = Kosto e borxhit**

- 7.10 ERE do te percaktoje vleren e pershtatshme te kthimit mbi kapitalin e vet (pas takses) per kompanine prodhuese, e cila do te jete norma pa risk e bonove te thesarit plus primin e riskut, i cili ka te beje me riskun qe shoqeron normalisht nje kompani prodhimi te energjise elektrike. ERE mund te perdore metodologji te ndryshme per te percaktuar normen e pershtatshme te kthimit mbi kapitalin e vet. ERE mund te perdore disa faktore per te percaktuar kthimin mbi kapitalin e vet, te cilat perfshijne, por nuk kufizohen ne : (1) krahasimin me kompani qe kane risk te ngjashem; (2) terheqja e kapitalit; (3) kushtet aktuale ekonomike dhe financiare; (4) koston e kapitalit; (5) riskun e kompanise; (6) politikat financiare dhe strukturen e kapitalit te shoqerise ; (7) kompetencat e manaxhimit dhe (8) historikun financiar te kompanise.
- 7.11 ERE do te percaktoje koston e normalizuar te borxhit per te llogaritur normen e interesit te komponentit te borxhit. Llogaritja do te bazohet ne normat e interesit per borxhin e papaguar te kompanise prodhuese. Normat e interesit te perdorura per te percaktuar te ardhurat e kerkuara mund ose jo te jene te njejta me normat e interesit aktuale te borxhit. Kompania prodhuese duhet te tregoje se normat e interesit per borxhin jane ne te njejten linje me normat e interesit per borxhin e supozuar nga kompani me risk te ngjashem te kreditimit. Borxhet e perfshire ne llogaritjen e normes mesatare te interesit per borxhet dhe qe kane nje norme interesi shume me te larte se niveli aktual i tregut, do te rregullohet ne renie drejt nivelit te tregut.



- 7.11.1 Norma mesatare e ponderuar interesit per borxhet afatgjate do te percaktohet si shuma e pagesave te interesave te borxhit afatgjate gjate vitit baze, duke e pjestuar me totalin e principalit te borxhit afatgjate (sasia totale e borxhit) ne fillim te vitit baze.
- 7.11.2 Raporti i borxhit afatgjate dhe objektivat per periudhat tranzitore te perkoheshme caktohen nga ERE brenda nje vendimi tarife dhe aplikohet mbi Bazen e Rregulluar te Aseteve per nje periudhe rrethullatore.

## **8. Rishikimi vjetor i aftësisë së KPP-së për të financuar shpenzimet kapitale**

- 8.1 KPP-ja (per cdo njesi te saj te prodhimit) duhet t'i sigurojë ERE-s një pasqyrë financiare vjetore për vitin me te fundit që mbaron në 31 Dhjetor, si dhe një dokument të parashikimit të pasqyrave financiare për secilin nga tre vitet pasues. Pasqyrat financiare do të përfshijnë një raport të fluksit të parasë (cash flow) që tregon burimet dhe përdorimet e fondeve.
- 8.2 KPP-ja (per cdo njesi te saj te prodhimit) siguron një parashikim të pasqyrave financiare për tre vjet, te cilat identifikojne burimet e fondeve të përdorura për të mbuluar shpenzimet kapitale vjetore. Raportimi duhet të shoqërohet gjithashtu me një dokument që shpjegon nevojën për projekte te ndertimit apo rindertimit ne programin vjetor te shpenzimeve kapitale.

## **9. Alokimi i kostove te kapacitetit dhe te energjise**

- 9.1 Furnizuesi Publik me Shumice duhet te beje nje pagese per kapacitet, ne leke/KW/muaj, i bazuar ne kapacitetin e kontraktuar te KPP..
  - 9.1.1 Per hidrocentralet kapaciteti i garantuar eshte i bazuar ne planin vjetor te prodhimit te hartuar ne perputhje me rregullat e tregut.
  - 9.1.2 Pagesat per kapacitet per hidrocentralet perfshijne 85% te kosos totale fikse te prodhimit.
  - 9.1.3 Per termocentralet, kapaciteti i garantuar eshte me i ulet i kapacitetit te kontraktuar, ose llogaritja e disponibilitetit aktual te centralit gjate oreve pik te muajit. OST-ja do mbaje te dhena lidhur me disponibilitetin e centralit dhe do t'i raportoje ERE-s mbi baza mujore lidhur me disponibilitetin e cdo njesie prodhimi)

- 9.1.4 Pagesa qe lidhen me kapacitetin per termocentralet perfshin te gjitha kostot fikse te centralit (te gjitha kostot pervec lendes djegese apo derivatet e saj, dhe kostot variabel operative te operimit dhe mirembajtjes).
- 9.2 Furnizuesi Publik me Shumice duhet te beje nje pagese per energji, ne leke/kWh, te bazuar ne numrin e kWh te levruar nga centralet/njesite prodhuese gjate muajit te faturimit.
- 9.2.1 Pagesat per energji per hidrocentralet perfshijne te gjitha kostot variabel plus 15% te kosos totale fikse te centralit, me qellim qe kompania publike e prodhimit te kete nxitje per te ruajtur disponibilitetin per te prodhuar energji elektrike. Tarifa e energjise per hidrocentralet llogaritet si totali vjetor i kostove te lartpermendura pjestuar me prodhimin e pritshem te energjise elektrike per vitin.
- 9.2.2 Pagesat per energji per termocentralet perfshijne te gjitha kostot variabel te centraleve (lende djegese, derivatet e tyre dhe kostove variabel operative dhe te mirembajtjes). Tarifa e energjise per termocentralet llogaritet si kosto variable totale vjetore pjestuar me prodhimin e pritshem te energjise elektrike per vitin. Tarifa e energjise do te rregullohet cdo muaj bazuar ne eficencen e centralit/njesise prodhuese, dhe ne indeksin rajonal te cmimit te naftes (derivateve te saj).

## **10. Afatet**

- 10.1 KPP do te paraqese per secilen njesi prodhuese specifikat per RAB-in e saj ne aplikimin per tarife qe do te beje ne vitin 2009.
- 10.2 Bazuar ne kete metodologji, KPP-ja duhet ti paraqese ERE-s nje kerkese per miratimin e tarifave te reja, jo me vone se 6 muaj perpara dites qe tarifat e propozuara te hyjne ne fuqi.
- 10.3 Per tre periudhat e par ate rregullimit, struktura e kapitalit te synuar per Kompanine Publike te Prodimit do te percaktohet sipas Deklarates Rregullatore te publikuar nga ERE.
- 10.4 Vlera e lejuar e kthimit nga kapitali i vet pas takse fillimisht do te jete sipas Deklarates Rregullatore te publikuar nga ERE.
- 10.5 KPP-ja -ja do te koordinoje me OST-ne qe te zhvillojne nje studim inxhinierik, ekonomik dhe marketingu mbi sherbimet ndihmese, per te percaktuar tarifat per sherbimet ndihmese per periudhen 2010-2014. Studimi duhet te kryhet dhe te paraqitet ne ERE me 31 Djetor 2008..

## **10. Dispozita perfundimtare**

Metodologjia e per llogaritjen e tarifave te KPP u miratua nga Bordi i Komisionereve te ERE me Vendimin nr. 77, date 26/06/2008